

**QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE
GLAVNI CENTAR PORODIČNE MEDICINE - MAIN FAMILY HEALTH CENTRE
GJAKOVË - ĐAKOVICA - GJAKOVA**

Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Gjakovës - Opština Đakovica - Municipality of Gjakova

 **ARKIVA DALËSE
IZLAZNE ARHIVE
OUTPUT ARCHIVES** 

Nr. Inv./Br. Inv. 05-05214-7709 Nr. faqe/Br. Str./No. Pg. 12021016
Data/Datum/Date 12.02.2016

Gjakovë - Đakovica - Gjakova



RAPORT PUNE PËR VITIN 2025

GJAKOVË

Janar 2026

PËRPILUAR NGA STAFI MENAXHERIAL I QKMF GJAKOVË

PËRMBAJTJA

I. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE	3
II. ORGANIZIMI I SISTEMIT TË KUJDESIT PARËSORË SHËNDETSORË (KPSH)	3
Misioni	3
Vizioni	4
Qëllimi dhe objektivat	4
III. ORGANIZIMI DHE PUNA E QENDRËS KRYESORE TË MJEKËSISË FAMILJARE	4
Organizimi i QKMF	4
1. Struktura organizative e QKMF	5
2. Shërbimet shëndetësore	5
3. Rrjeti i institucioneve të KPSH të Gjakovës	6
4. Burimet njerëzore	7
5. Financimi	9
6. Donacionet	12
7. Performanca	13
7.1. Qendra e informimit për diabet, hipertension dhe ASTMA	14
7.2. Kujdesi Paliativ	15
7.3. Mamografia	16
7.4. Urgjenca	16
7.5. Vaksinimi	17
7.6. Barnatorja Qendrore e QKMF	19
7.7. Laboratori	20
7.8. Qendra e Trajnimit të Mjekësisë Familjare (QTMF)	20
7.9. Njesia e SISH	21
8. Morbiditeti	22
9. Zhvillimi profesional i stafit	23
10. Edukimi shëndetësor i komunitetit	23
10.1. Komiteti për Siguri dhe Cilësi të Shërbimeve Shëndetësore (KSCShSh)	24
11. Departamenti i Administratës në QKMF	24
12. Sfidat	25
13. Rekomandimet	25
14. Përfundimet	26
V. SHTOJCAT	26

RAPORT PUNE I QKMF-së PËR VITIN 2025

I. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) e komunës së Gjakovës, përmes këtij raporti prezanton punën një vjeqare të arritjeve dhe sfidave gjatë vitit punues 2025. QKMF si bartës organizativ dhe funksional i përkujdesjes parësore shëndetësore të popullatës së komunës së Gjakovës ka për qëllim përmirësimin e shëndetit të popullatës dhe këtë e realizon përmes sigurimit të shërbimeve shëndetësore të arritshme, të levërdishme, gjithëpërfshirëse, të vazhdueshme dhe të koordinuara, në të gjitha institucionet e veta.

Institucioni ka për mision ofrimin e shërbimeve shëndetësore cilësore dhe të sigurta, të ndërtuara mbi parimet e konceptit të Mjekësisë Familjare, të drejtuara nga nevojat dhe kërkesat e individëve, familjeve dhe bashkësisë, me synim promovimin, ruajtjen dhe përmirësimin e shëndetit të të gjithë qytetarëve të vendit dhe si vizion e ka arritjen e shëndetit më të mirë të mundshëm të popullatës përmes jetësimit të plotë të konceptit të Mjekësisë Familjare.

Qëllimin dhe objektivat e punës, QKMF i ka të identifikuar dhe të bazuar në nevojat dhe kërkesat aktuale shëndetsore të popullatës së komunës, bazuar në politikat e Drejtoratit për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale (DSHMS) të komunës së Gjakovës, konform ligjeve egzistuese, politikave dhe standardeve të përcaktuara nga Ministria e Shëndetsisë së Kosovës.

Aktivitetet. Gjatë kësaj periudhe raportuese, aktivitetet e planifikuara janë realizuar me sukses nga ana e personelit shëndetësorë dhe atij jo shëndetësorë të QKMF, përfshirë mbështetjen dhe bashkëpunimin e plotë me DSHMS të komunës së Gjakovës.

Punëtorët dhe profesionalistët e Kujdesi Parësorë Shëndetësorë, gjatë periudhës njëvjeçare, kanë mundësuar realizimin e gjithsejtë 525,627 shërbime: prej tyre 196,235 vizita dhe 329,392 shërbime gjegjësisht u është ofruar ndihmë dhe përkujdesje shëndetësore për pacientët dhe klientët të sistemit të KPSH që kryesisht kanë qenë banorë të komunës së Gjakovës.

Gjithashtu janë realizu edhe vizitat sistematike të nxënësve të shkollave fillore dhe shkollat e mesme të ulta; kl. I-rë, kl. V-të dhe kl. IX-të, në Komunën e Gjakovës, totali i vizitave 5,198 dhe atë të vizituar nga Mjekët Familjar janë realizuar 2,789 me 18 parametra dhe nga mjekët stomatolog 2,409 me 8 parametra. Gjatë periudhës kohore që po raportohet, është realizuar me sukses pjesa më e madhe e aktiviteteve të planifikuara, përfshirë mirëmbajtjen e infrastrukturës së institucioneve, forcimi i kapaciteteve profesionale (EVP) dhe të atyre operative, është vazhduar me furnizimin me pajisje në KPSH, është realizuar mjaftueshëm siguri dhe furnizimi i kënaqshëm i popullatës me barna dhe materiale të ndryshme, si dhe është realizuar me sukses përkrahja për pacientët, Institucionet publike si dhe Organizatat Joqeveritare.

II. ORGANIZIMI I SISTEMIT TË KUJDESIT PARËSORË SHËNDETSORË (KPSH)

Sistemi i Kujdesit Parësor Shëndetësorë (KPSH) i komunës së Gjakovës është bartës dhe përgjegjës për organizimin, implementimin dhe sigurimin e vazhdimësisë së aktiviteteve për përmirësimin e shëndetit të popullatës, dhe këtë e bën përmes sigurimit të shërbimeve shëndetësore të arritshme, të levërdishme, gjithëpërfshirëse, të vazhdueshme dhe të koordinuara me të gjitha institucionet.

Misioni. Sistemi i Kujdesit Parësor Shëndetësorë (KPSH) të Gjakovës, bazohet në ofrimin e shërbimeve shëndetësore cilësore dhe të sigurta, të ndërtuara mbi parimet e konceptit të Mjekësisë Familjare, të drejtuara nga nevojat dhe kërkesat e individëve, familjeve dhe bashkësisë, me synim promovimin, ruajtjen dhe përmirësimin e shëndetit të të gjithë qytetarëve të vendit.

Vizioni. Arritja e shëndetit më të mirë të mundshëm të popullatës përmes jetësimit të plotë të konceptit të Mjekësisë Familjare është vizioni i sistemit të KPSH të Gjakovës.

Qëllimi dhe objektivat. Qëllimi kryesorë i sistemit të Kujdesit Parësor Shëndetësor është përmirësimi i shëndetit të popullatës, përmes sigurimit të shërbimeve shëndetësore të arritshme, të levërdishme, gjithëpërfshirëse, të vazhdueshme dhe të koordinuara, në të gjitha institucionet.

KPSH është porta hyrëse në sistemin e kujdesit shëndetësor, e cila shërben si pikë koordinuese për të gjitha shërbimet e tjera shëndetësore sipas nevojës. KPSH garanton:

- Barazi në dhënjen e shërbimeve, drejtësi sociale dhe përfshirje të të gjithë qytetarve në kujdesin për shëndetin e tyre.
- Forcon konceptin e sistemit i cili është i orientuar në përmbushjen e nevojave në rritje për shërbime shëndetësore me qëllim të arritjes së indikatorëve sa më të mirë të shëndetit të popullatës dhe performancës së vet.
- Promovon dhe do të e mbrojnë shëndetin e individëve dhe bashkësisë duke i integruar politikat dhe aktivitetet e shëndetit publik dhe promovuar shfrytëzimin sa më racional të resurseve ekzistuese.
- Promovon dhe mbështetë përfshirjen dhe pjesëmarrjen aktive të individëve dhe përfaqësuesve të bashkësisë, në vlerësimin dhe planifikimin e nevojave lokale për shërbime shëndetësore, duke bërë të mundur forcimin e besueshmërisë dhe përgjegjësisë së autoriteteve shëndetësore në mesin e popullatës, me qëllim të realizimit sa më të përpiktë të politikave të përcaktuara si dhe përmbushjen e zotimeve të tyre.
- Mbulueshmëria e të gjithë banorëve me shërbime të mjekësisë familjare
- Ofrimi i shërbimeve shëndetësore sipas standardeve të përcaktuara
- Vetëdijësimi i popullatës për shërbimet në kujdes parësor shëndetësor përmes aktiviteteve promovuese me qëllim të vetëdijësimit të tyre për mjekësi familjare.

III. ORGANIZIMI DHE PUNA E QENDRËS KRYESORE TË MJEKËSISË FAMILJARE (QKMF)

Organizimi i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare të Gjakovës.

Strategjia dhe objektivat e punës së Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) si bartës operativ i KPSH janë të bazuara në planin gjithëpërfshirës të organizimit dhe funksionimit të sistemit të KPSH në komunën e Gjakovës.

Drejtorati Komunal për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale (DShMS) e bën planifikimin, organizimin dhe implementimin e aktiviteteve të sistemit të KPSH, konform rregullave dhe standardeve të përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë së Kosovës, e cila e bën mbikqyrjen e procesit të implementimit të politikave dhe aplikimit të standardeve shëndetësore aktuale.

Kujdesi parësor shëndetësor në Komunën e Gjakovës zbatohet nga QKMF duke u udhëhequr nga parimet vijuese, të specifikuara në Ligjin për Shëndetësi të Kosovës:

- Barazia
- Cilësia
- Ndershmëria dhe përgjegjësia
- Gjithë përfshirja dhe jo diskriminimi
- Financimi i qëndrueshëm
- Financimi kosto-efektiv
- Bashkëfinancimi

1. Struktura organizative e QKMF

Me qëllim të ofrimit të përkujdesjes shëndetësore cilësore dhe të qasëshme për të gjithë banorët e komunës, KPSH përmes QKMF-së organizohet në këto njësi funksionale përbërëse:

1. Departamenti i Mjekësisë Familjare

- 1.1. Sektori i Mjekësisë Familjare
- 1.1.2. Njësia e SISH
- 1.1.3. Njësia e Vaksinimit dhe Imunizimit,
- 1.1.4. Sektori i Shëndetit Oral Preventiv
- 1.1.5. Sektori i Kujdesit Urgjent
- 1.1.6. Sektori Konsultativ dhe Diagnostike
 - 1.1.6.1. Shërbimet Konsultative
 - 1.1.6.2. Kabineti Radiologjik
 - 1.1.6.3. Laboratori

2. Sektori i Administratës së QKMF

- 2.1. Zyrtar për Mbështetje Ligjore,
- 2.2. Zyrtar për Arkiv,
- 2.3. Zyrtar për Teknologji Informative,
- 2.4. Zyrtar për Administrimin e Depos,
- 2.5. Asistente për Arkë,
- 2.6. Nëpunësit Teknik dhe mbështetës.

3. Barnatorja Qendrore

2. Shërbimet shëndetësore

KPSH si portë hyrëse në Sistemin e Kujdesit Shëndetësor, si pikë kordinuese përfshinë këto shërbime:

- 1. Shërbimet e promovimit shëndetësor; përfshirë informimin, komunikimin dhe edukimin brenda institucioneve dhe në komunitet;
- 2. Shërbimet e imunizimit dhe vaksinimit dhe shërbimet tjera parandaluese;
- 3. Shërbimet esenciale kurative dhe ndërhyrje të vogla kirurgjike;
- 4. Shërbime të kujdesit akut dhe urgjent;
- 5. Shërbimet e kujdesit shëndetësor për sëmundjet kronike;
- 6. Shërbimet e kujdesit shëndetësor për fëmijë, adoleshentë dhe të rinjë;
- 7. Shërbimet e shëndetit riprodhues;
- 8. Shërbimet e shëndetit oral, parandalues dhe shërbimet specialistike stomatologjike;
- 9. Shërbimet e shëndetit mendor;
- 10. Shërbimet e kujdesit shtëpiak përfshirë shërbimet e kujdesit ndaj nënës dhe fëmijës, vizitat sistematike në shkollë dhe qerdhe, kujdesi paliativ si dhe kujdesi shtëpiak bazuar në nevojat e qytetarëve dhe prioritetet e shëndetit publik;
- 11. Shpërndarjen e barërave nga lista esenciale, si dhe
- 12. Shërbimin e Mamografisë, entgenin e dhëmbëve dhe analizat laboratorike (një laborator qendror dhe 4 laboratore në katër QMF në regjione).

3. Rrjeti i institucioneve të KPSH të Gjakovës

QKMF përbëhet nga rrjeti i institucioneve të KPSH të shtrira në gjithë komunën e Gjakovës, përfshirë qytetin dhe 4 regjione gjeografike të pjesës rurale të komunës:

Qendrat e Mjekësisë Familjare të KPSH të Gjakovës	
1. QKMF	"Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare"
2. QMF 1	"QKMF e vjetër"
3. QMF 3	"Brekoc"
4. QMF 4	"Orize"
5. QMF 5	"Ereniku"
6. QMF 6	"Ponoshec"
7. QMF 7	"Skivjan"
8. QMF 8	"Cermjan"
9. QMF 9	"Rogovë"
10. QMF 10	"Dardani"

I. REKA E KEQE:

QMF 6 - Ponoshec (Qendra e Mjekësisë Familjare me 5 AMF)

1. Molliq	(AMF)
2. Sheremet	(AMF)
3. Guskë	(AMF)
4. Korenicë	(AMF)
5. Babaj Bokës	(AMF)

II. REKA E MIRË:

QMF 7 - Skivjan (Qendra e Mjekësisë Familjare)

1. Novosella e Epërme	(AMF)
-----------------------	-------

III. DUSHKAJA :

QMF 8 - Cermjan (Qendra e Mjekësisë Familjare me 5 AMF)

1. Gergoc	(AMF)
2. Kralan	(AMF)
3. Doblibare	(AMF)
4. Shqiponjë	(AMF)
5. Bec	(AMF)

IV. HASI:

QMF 9 - Rogovë (Qendra e Mjekësisë Familjare me 3 AMF)

1. Damjan	(AMF)
2. Lipovec	(AMF)
3. Bistazhin	(AMF)

QMF 3 - Brekoc (Qendra e Mjekësisë Familjare me 1 AMF)

1. Dol	(AMF)
--------	-------

Qendra e Kujdesit Paliativ

1. Qendra e Kujdesit Paliativ – e aktivizuar në 31 Maj 2025

Sistemi i KPSH në Gjakovë e siguron mbrojtjen shëndetësore parësore të popullatës e cila jeton në regjionin gjeografik dhe administrativ të komunës së Gjakovës, duke e zbatuar konceptin e Mjekësisë Familjare. Bazuar në Ligjin për Shëndetësi, organizohet sistemi i Kujdesit Parësor Shëndetësor të Komunës së Gjakovës dhe i njejti obligohet që:

- Në QKMF, respektivisht në Sektorin e Kujdesit Urgjent ofrohen shërbimet shëndetësore gjatë 24 orëve, ndërsa në Mjekësin Familjare dhe Stomatologji është e organizuar puna në dy ndërrime si dhe sistemi i kujdestarisë. Ndërkaq QMF funksionojnë me dy ndërrime dhe AMF me një ndërrim.
- Në QKMF shërbimet shëndetësore në Sektorin e kujdesit urgjent ofrohen me aplikimin e sistemit të kujdestarisë gjatë 24 orëve, dhe në Mjekësin Familjare organizohet puna me dy ndërrime. Ndërsa në QMF puna organizohet me dy ndërrime dhe në AMF me një ndërrim.
- Në Qendren e Kujdesit Paliativ ofrohen shërbimet me dy ndërrime dhe gjatë vikendeve.
- Organizohet dhe zbatohet zhvillimi i vazhdueshëm profesional
- Organizohet shpërndarja e barnave nga lista esenciale si edhe i mjeteve tjera ndihmëse mjekësore, të specifikuar në regjistrin zyrtar

4. Burimet njerëzore

Njëri ndër elementet më të rëndësishme të zhvillimit të sistemit që parashihet me politikat shëndetësore dhe me politikat zhvillimore të Komunës së Gjakovës, janë resurset humane, gjegjësisht stafi i sistemit të KPSH të Komunës. Stafi shëndetësor i trajnuar, i motivuar dhe aktiv në realizimin e planit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional, është një ndër shtyllat kryesore të sistemit të KPSH të Komunës. Këtu përfshihen mjekët e specializuar në MF, mjekët e përgjithshëm, specialistë të stomatologjisë, stomatologët si dhe infermierët e trajnuar/a përfshi këtu teknik dhe asistente të stomatologjisë.

KPSH e Komunës së Gjakovës, me qëllim të funksionimit sa më të mirë të këtij sistemi, i kushton vëmendje të veçantë zhvillimit të burimeve njerëzore, përmes trajnimeve efektive dhe punës ekipore, me të cilin rast të avancohen njohuritë, aftësitë, qëndrimet dhe praktikat e punës së të gjithë personelit. Zhvillimi i vazhdueshëm profesional, specializimi, trajnimi i infermiereve si dhe trajnimet e personelit tjetër, paraqesin format përmes të cilave arrihet ngritja e aftësive profesionale dhe menaxheriale të personelit aktual të KPSH të komunës së Gjakovës.

Për të e rritur dhe përshpejtuar zhvillimin e burimeve njerëzore të institucionit, DKShMS dhe QKMF të Komunës së Gjakovës, do të sigurojnë zbatimin e plotë të politikave shëndetësore dhe kërkesave për rritjen e numrit të mjekëve familjarë. Njëherit, do të gjenden dhe do të operacionalizohen mekanizmat dhe format efektive për motivimi shtesë lidhur me orientimin e mjekëve të përgjithshëm drejtë specializimit të mjekësisë familjare si dhe do të bëhet lobimi për ngritjen e gradimit të punëtorëve shëndetësorë në favor të ekipit të Mjekësisë Familjare. Kjo është dhe do të mbetet detyrë e vazhdueshme e personelit dhe e partnerëve të KPSH. Specializimi nga Mjekësia Familjare gjatë viteve të kaluara ka mundur që një numër i konsiderueshëm i mjekëve në KPSH të marrin njohuri të nevojshme në këtë lëmi. Programi i Edukimit Specialistik në Mjekësi Familjare është i akredituar ndërkombëtarisht nga Kolegji Mbretërorë i Mjekëve të Përgjithshëm të Britanisë së Madhe (RCGP) dhe që nga viti 2005 është pranuar si program tre vjeçar i specializimit në Kosovë.

Sa i përket infermierëve të cilët janë pjesë përbërse e ekipit të MF, pjesa dërmuese e tyre në KPSH të Gjakovës, e kanë kompletuar trajnimin nga Mjekësia Familjare si dhe e kanë kompletuar një numër të konsiderueshëm të trajnimeve nga fushat e ndryshme të KPSH, duke e krijuar kështu një potencial që i përmbushë nevojat e komunitetit të cilit u ofrohen shërbime shëndetësore.

Në Dhjetor të vitit 2025, numri i punëtorëve shëndetësor në KPSH është 346, ndërkohë që numri total i lejuar është 355. Sipas gjinisë: femra janë 261 apo 75.43%, ndërsa meshkuj 85 apo 24.57%.

Stafi është i sistemuar sipas kategorise profesionale: 35 Mjekë Familjare, 2 mjeke ne programin specialistik postdiplomik (mjekësi familjare), 1 Interniste - konsulente, 43 mjekë të përgjithshëm, 133 staf i mesëm shëndetësor (infermiere – 21 me bachelor), 5 specialistë të stomatologjisë dhe 3 stomatolog ne specializim, 27 stomatolog të kujdesit preventiv, 10 teknik të dhëmbëve (1 me bachelor), 1 teknik i rentgenit, 49 asistente të stomatologjisë (1 me bachelor), 1 farmacist, 5 teknik të farmacisë, 1 mjeke specialiste e biokimise klinike, 1 kimiste, 9 teknik laborant, 6 SISH, 9 punëtor administrativ (1 edukim superior, 2 me fakulltet dhe 4 me bachelor), 2 në shërbimin teknik dhe 10 vozitës.


Stafi shëndetësor i KPSH është i plotësuar me: 5 Magjistra në Menaxhimin Shëndetësor nga profili i Mjekësisë Familjare, gjithashtu në zhvillimin e konceptit të Mjekësisë Familjare janë të angazhuar: 2 Mjekë Familjar në Programin specialistik postdiplomik për Mjekësi Familjare dhe 3 stomatologë.

Bazuar ne Sistemin e Menaxhimit te Cilësisë i cili përcakton ngritjen e cilësisë se shërbimeve shëndetësore kemi përmbushjen e pjesërishme të këtyre objektivave të përcaktuara në afate kohore.

Tab.1 Burimet njerëzore në QKMF sipas thirrjes profesionale dhe gjinisë

Thirrja profesionale	Numri i personelit sipas gjinisë		
	F	M	Gjithësej
Specialist i Mjekësisë Familjare	23	12	35
Mjekë në specializim		2	2
Mjekë të përgjithshëm	22	21	43
Specialist të tjerë	1		1
Stomatolog - specialista	3	2	5
Stomatolog ne specializim	2	1	3
Stomatolog	17	10	27
Infermier	112	21	133
Ro- teknik		1	1
Teknik të dhëmbëve	8	6	14
Asistentë të stomatologjisë	44	1	45
Laborant superior	2		2
Teknik laborant	6	3	9
Farmacist		1	1
Teknik farmacist	4	1	5
Administrata - superior	1		1
Administrata	4	3	7
Sherbimi teknik	2		2
Vozites	10		10
Gjithësejt	261	85	346

Burimet njerëzore në QKMF sipas thirrjes profesionale dhe gjinisë



5. Financimi

Sistemi i Kujdesit Parësor Shëndetësor i Gjakovës, aktualisht financohet tërësisht nga buxheti i shtetit gjegjësisht financohet drejtëpërdrejtë nga Qeveria e Kosovës (Ministria e Financave të Kosovës), përmes Grantit për shëndetësi të Komunave dhe bashkpagesave. Aktualisht nuk egzistojnë burime tjera të të hyrave sikur që është rasti me të gjithë sistemin e KPSH në Kosovë.

Komuna i realizon bashkëpagesat dhe të hyrat tjera vetanake që vijnë nga puna e përditshme e institucioneve shëndetësore por këto paraqesin dhe bëhen pjesë përbërëse e buxhetit të qeverisë (në pajtim me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike). Pasi që në Kosovë ende nuk ekziston sigurimi shëndetësor publik i detyrueshëm, rrjedhimisht nuk ka kontribute potenciale që do të mund të kolekttoheshin me këtë mekanizëm dhe njëherit nuk ka edhe fonde të mjaftueshme për funksionimin më të lehtë të sistemit në fjalë.

Infrastruktura

Menaxhmenti i KPSH të komunës së Gjakovës dhe DShMS, zhvillimin e infrastrukturës fizike dhe paisjen e institucioneve, e kanë realizuar përmes aktiviteteve të bazuara në dokumentet: “Udhëzimet administrative”: “UA Nr. 03/2020 Organizimi, Struktura, Percaktimi i Shërbimeve dhe Veprimtarisë së Institucioneve të Kujdesit Parësor Shëndetësors” si dhe Statuti i QKMF-së numër 01-110/04-10966 i miratuar nga Kuvendi i Komunës Gjakovë në mbledhjen e datës 26.02.2025,

- Është realizuar rishikimi dhe revidimi i infrastrukturës fizike aktuale të KPSH.
- Standardizimi dhe kompletimi i infrastrukturës fizike të KPSH, pajisja dhe mirëmbajtja e pajisjeve në të gjitha institucionet e KPSH.

Të gjitha objektet që shfrytëzohen për të u ofruar pacientëve shërbime shëndetsore parësore u janë përshtatur qëllimit dhe dedikimit të tyre, si dhe pajisjet dhe aparaturat janë të sigurta dhe në gjendje të mirë.

Në tabelat më poshtë janë paraqitur pasqyrat e të hyrave, shpenzimet komunale dhe ato të autoparkut (dinamika krahasuese me vitin e kaluar) ku vërehet trendi pozitiv në të tri pozicionet, krahasimi i bashkëpagesave me vitin paraprak: 2024 - 112,027.90 €, ndërsa në vitin 2025 – 106,928.40 €.

Tab. 2 Pasqyra e të hyrave në KPSH Gjakovë për vitin 2024 dhe krahasimi me vitin 2025

	PËRSHKRIMI	Gjithësej 2024	Gjithësej 2025
	Të hyrat		
1	Gjendja në arkë më 31.12.2024 (0.00€)	0.00	0.00
2	Të hyrat nga participimi	104,814.40	98,457.40
3	Të hyrat nga participimi për certifikata mjekësore	4,965.00	6,510.00
4	Të hyrat nga participimi për proteza	1,900.00	1,700.00
5	Të hyrat nga participimi për aparat ortodontik	87.00	25.00
6	Ndërhyrje kirurgjike-stomatologji	36.00	36.00
7	Të hyrat nga pagesa për shfrytëzim të autoambulancës	225.50	200.00
	Gjithësej të hyra	112,027.90	106,928.40
	Gjendja në arkë më 31.12.2025 (0.00€)		

Tabela 3. Pasqyra krahasuese e bashkëpagesave në KPSH Gjakovë për vitet 2023, 2024 dhe 2025

	Pa pagesë	Me pagesë	Totali €
2023	136,921	53,386	190,307.00
2024	139,144	56,277	195,421.00
2025	137,364	52,258	106,928.40

Pasqyra krahasuese e bashkëpagesave në KPSH Gjakovë për vitet 2023, 2024 dhe 2025




Tabela 4. Pasqyra krahasuese e shpenzimeve komunale në KPSH Gjakovë për vitet 2024 dhe 2025

	KEDS	PTK	Interneti	Hidrosistemi	Çabрати	Ngrohtorja	Totali i shpenzimeve në KPSH
2024	33,565.82	491.63	227.88	10,465.97	6,514.48	7,610.57	58,876.35 €
2025	42,928.85	496.23	227.88	8,714.06	5,599.80	9,158.52	67,125.34 €





Tabela 5. Pasqyra krahasuese e shpenzimeve të autoparkut në KPSH Gjakovë për 2024 dhe 2025

	Karburant i harxhuar ne litra	Kilometra të kaluara
2024	11,563	121,194 km
2025	13,198	195,309 km



6. Donacionet

Gjatë vitit 2025 janë realizuar donacione nga: MSh (autoambulancë) dhe AQH (orendi për zyre dhe mjete te punes):

Donatori	Data	Artikulli	Sasia
M.Sh.	15.12.2025	Autoambulancë	1
AQH	12.02.2025	Chair for the doctor	6
		Patient Chair Stool Seat	6
		Bed for the emergency room	2
		Classic examination bed	2
		Wing screen mobile	5
AQH	07.03.2025	Karrika statike	3
		Tavoline instrumentesh	3
		Raft inox	4
		Karrige statike metalike 3	6
		Raft Metalik	2
		Raft Metalik	1
		Varese rrobash	3
		Shkalle ngjitjeje me dy shkalle	4
		Karrige me sedilje	4
		Shporta te mbeturinave	6
		Kondicioner Bruno 12	2
		Karrik statike me ngjyra	12
		Karrik per infermier	2
		Wooden desk with 4 drawers attached	1
		Rocking chair	1
		Wooden cupboard white color with 6 Shelves	1
AQH	23.07.2025	Wooden shelve	1
		Wooden Sensory wall	1
		Komplet tavolin pune per infermiere	1
		Karrik konsultime statike	1
		Varese rrobash	1
		Dollap metalik 4sirtare	1
AQH	18.09.2025	Waal mounted sphygmomanometer	20
		Aneroid sphygmomanometer	40
		Mobile Aneroid spygmomanometer	5
		Stethoscope	40
		Finger pulse oximeter	40
		Otoscpoe and ophthalmoscope	10
		Infrared thermometer	10
		Tick Removal	27
		Nebulizer	12
		Autoclave	1

7. Performanca e shërbimeve shëndetësore

Gjatë periudhës së raportuar në KPSH janë realizuar gjithsejtë:

- 525,627 shërbime, prej tyre 196,235 vizita dhe 329,392 shërbime si dhe 5198 vizita sistematike në shkolla.

Në Mjekësinë Familjare janë realizuar:

- 475,039 shërbime shëndetësore, nga keto kanë qenë 178,200 vizita shëndetësore dhe 296,839 shërbime shëndetësore si dhe 2789 vizita sistematike në shkolla me 18 parametra,
- Nga Mjekësia Familjare në Spitalin Regjional janë referuar: 20,417 pacientë që tregon një mesatare sipas standardeve ndërkombëtarë me 11,48 %;


Në Stomatologji janë realizuar gjithsejtë:

- 50,588 shërbime e nga to vizita kanë qenë 18,035 dhe shërbime stomatologjike kanë qenë 32,553 si dhe 2409 vizita sistematike në shkolla me 8 para metra.

Tab 6. Pasqyra e vizitave dhe shërbimeve shëndetësore në Mjekësinë Familjare dhe Stomatologji në vitin 2024 dhe 2025

	Mjekësia familjare		Stomatologjia	
	Vizita	Shërbime	Vizita	Shërbime
2024	177856	305935	15173	35099
2025	178200	296839	18035	32553
TOTAL	475039		50588	

Pasqyra e vizitave dhe shërbimeve shëndetësore në Mjekësinë Familjare dhe Stomatologji në vitin 2024 dhe 2025



Tab. 7. Raporti i vizitave sistematike te nxënësit e shkollave fillore në komunën e Gjakovës

Shkollat	Vizitat nga Mjeku familjar	Vizitat nga Mjeku Stomatolog	Gjithsejt vizita sistematike në shkolla
Qytet	1375	1226	2601
Fshat	1414	1183	2597
Gjithsejt	2789	2409	5198

Tab. 8. Pasqyra e numrit të pacientëve sipas moshës dhe gjinisë: total 166,516

24 orë	Deri 1 Jave	Deri 1 Muaj	Deri 6 Muaj	Deri 1 Vjec	1 - 3 Vjec	3 - 6 Vjec	6 – 18 Vjec	18 – 65 Vjec		Mbi 65 Vj	
								F	M	F	M
0	22	176	410	2736	6672	8776	22597	45626	36307	23512	19682

Tab 9. Pasqyra e vizitave ne shtepi per nena dhe femije 0 – 3 vjeq (tabela 2023, 2024 dhe 2025)

	Numri i vizitave në shtëpi	Totali 2023	Totali 2024	Totali 2025
1	Numri i vizitave në shtëpi për fëmijët 0-3 vjeç	3214	3222	2668
2	Numri i vizitave në shtëpi për shtatzëna	377	365	178
	Numri total i vizitave në shtëpi	3591	3587	2846

Gjatë vitit 2025 janë raportuar 1539 lindje. Nga numri total i vizitave në shtëpi për komunitetin Rom, Ashkali dhe Egjyptian, janë kryer 763 vizita në shtëpi për fëmijet nga 0 – 3 vjeç dhe 47 gra shtatzëna.

7.1. QENDRA E INFORMIMIT PËR DIABET, HIPERTENSION DHE ASTMA


Gjatë viti 2025 kanë funksionuar dy qendrat: QMF Orize dhe QMF1.

Në QMF 1 janë kryer: 1671 vizita në këshillimore, gjithashtu janë shpërndarë: 119 libreta të diabetit dhe 67 libreta të Hipertensionit, ndërsa në QMF Orize, janë kryer: 1172 vizita në këshillimore si dhe 4 vizita për ASTMA, janë shpërndarë: 47 libreta të diabetit dhe 16 libreta të Hipertensionit, dhe janë bërë 261 thirrje telefonike për pacientë.

Tab. 10. Krahasimi i vizitave në këshillimore për pacientët me SKJN – 2024 dhe 2025

		Vizita ne keshillimore	Libreza Diabet	Libreza HTA	ASTMA	Thirrje telefonike
2024		2757	352	186	14	168
2025	TOTAL	2843	166	83	4	261
2025	QMF 1	1671	119	67	0	0
	QMF Orize	1172	47	16	4	261

Krahasimi i vizitave në këshillimore për pacientët me SKJN – 2024 dhe 2025



7.2. KUJDESI PALIATIV

Më 31 Maj 2025 është inauguruar qendra e Kujdesit Paliativ (në objektin e QMF Ereniku), nga bashkëfinancimi në mes AQH (50.000 €) dhe Kuvendit Komunal Gjakovë (100.000 €) si pjese e “Gjakova Qendër Demonstrimi” në projektin e AQH – përmirësimi i cilësisë së shërbimeve shëndetësore për qytetarët e Gjakovës.

Nga funksionalizimi qendra e Kujdesit Paliativ ka kryer në total 1,916 vizita dhe shërbime nga numri i përgjithshëm 2,937 i vizitave dhe shërbimeve për kujdesin paliativ në QKMF.

Qendra funksionon me ekipet mjekësore: një mjek dhe tre infermier, ditëve të javës (7-14 dhe 14-21) dhe gjatë vikendeve (7-21h). Ndërkohë është siguruar përveq linjes fikse (0390 310 682) edhe numri mobil (046 109 978) për kontakt me pacientët – i publikuar ne webfaqen e Komunës, rrjetet sociale si dhe përmes mediave lokale (TV syri dhe Radio Gjakova).

7.3. MAMOGRAFIA - Gjatë vitit 2025 qendra e Mamografisë (në QMF Ereniku) ka kryer në total 917 mamografi për pacientet e referuar në këtë qendër, ku 905 kanë qenë femra dhe 12 meshkuj, ndërsa 82 pjesëtar të komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian. DShMS nga data 17.10.2024 ka kontraktuar “Shërbime konsulente, mjekë specialistë – Radiolog për KPSH” për leximin e mamografive.

Tab. 11. Shërbimet në qendrën e Mamografisë për vitin 2025 dhe krahasimi me tri vitet paraprake:

	2022	2023	2024	2025
BIRADS 0	32	21	27	32
BIRADS 1	235	54	318	195
BIRADS 2	202	87	386	559
BIRADS 3	45	33	19	12
BIRADS 4	6	1	9	8
BIRADS 5	0	1	0	0
Q.K.U.K	7	4	2	0
Me vete	220	664	318	108
Total	849	865	1079	917
Minoritete	38	45	66	82
Meshkuj	0	3	10	12

7.4. URGJENCA - Gjatë periudhës raportuese, njësia e urgjencës ka kryer 31197 vizita, 3041 vizita shtëpijake dhe ka ofruar në total 56023 shërbime, njëherit ka referuar në spitalin regional 3017 raste apo 9.67 %, që është brenda normave të sistemit të mjekësis familjare.

Tab 12. Raporti nga shërbimi i urgjencës në QKMF, krahasimi në mes viteve 2024 dhe 2025

Njesia Urgjencës				
	Vizita	Vizita shtëpi	Vizita dhe shërbime	Referime spital
2024	29419	2861	50548	2908
2025	31197	3041	56023	3017

RAPORTI NGA SHËRBIMI I URGJENCËS NË QKMF, KRAHASIMI NË MES VITEVE 2024 DHE 2025



Pasqyra e shërbimeve shëndetësore për periudhën Janar – Dhjetor 2025 përmbledhet në fundë të raportit në Shtojcë e materialit.

7.5. VAKSINIMI

Njësia e Vaksinimit dhe Imunizimit është shërbim me rëndësi të veçantë për shëndetin e fëmijëve, dhe në organizimin e saj investohet vëmendje e veçantë. Vaksinimi i rregullt i fëmijëve kryhet në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) dhe në QMF-te (QMF1, QMF Orize, QMF Erenik, QMF Dardani, QMF Ponoshec, QMF Rogovë, QMF Cërmjan dhe QMF Skivjan), po ashtu edhe në shkollat fillore dhe të mesme në tërë territorin e komunës sonë, si në qytet dhe në fshatra, sipas programit dhe skemës së obligueshme të vaksinimit, gjithashtu dhe vaksinimi kundër gripit sezonal. Ky shërbim ofrohet nga profesionistë të trajnuar posaçërisht për administrimin e vaksinave. Ekipet e Mjekësisë Familjare bëjnë vlerësimet e nevojshme për gjendjen shëndetësore të fëmijëve përpara aplikimit të vaksinave.

Me 08.08.2023 është aprovuar Ligji nr. 08/L-200 për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve ngjitëse, ku neni 14, paragrafi 1.7.2 përcakton: *“prindi apo kujdestari i fëmijës obligohet që të respektoj kalendarin e rregullt të vaksinimit duke përfshirë edhe rekomandimet e mjekut”*.

Nga Tetori 2023, ka filluar aplikimi i kalendarit të ri të vaksinimit i përpiluar nga IKShPK Prishtinë për Programin e Zgjeruar të Imunizimit, të aprovuar nga Ministria e Shëndetësisë, me shtimin e tri vaksinave të reja: vakcina kundër Pneumokokut, Rotavirusit dhe Human Papilloma virusit.

Ne total gjate vitit 2025 janë administruar 27,210 vakcina, nga ato 24,984 ne programin e rregullt të vaksinimit – per 13,699 femije) dhe 2,226 vakcina BCG + Hepatit B (per 1,113 femije ne spital).

Kalendari i ri i Vaksinimit sipas IKShPK i aprovuar nga Ministria e Shëndetësisë nga viti 2025

 REPUBLICA E KOSOVES Republika e Kosovës / Republika e Kosovo Qyteti i Vucit / Qyteti i Vucit  Ministria e Shëndetësisë / Ministrarsvo Zdravstva / Ministry of Health Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës Nacionalni Institut za Javno Zdravstvo Kosova / National Institute of Public Health of Kosovo								
KALENDAR I VAKSINIMIT								
	Moshë në muaj				Moshë në vjet			
	Në lindje	2 muaj	4 muaj	6 muaj	12-15 muaj	5-6 vjeç (KL I)	11-12 vjeç (KL VI)	17-18 vjeç (KL XIII)
Tuberkuloz	BCG ¹							
Hepatit viral B	HepB ²	HepB ²		HepB ²				
Difteri, Tetanoz, Pertusis		DTaP ³	DTaP ⁴	DTaP ³	DTaP ⁴			
Infeksione nga Haemophilus influenzae tip b		Hib ⁵	Hib ⁴	Hib ⁴	Hib ⁴			
Polliomieliti		IPV ⁶	IPV ⁴	IPV ³	IPV ⁴	BoPV ⁸	BoPV ⁸	
Rotavirus		Rota ⁷	Rota ⁴					
Infeksione nga pneumokoku		PCV ⁹	PCV ⁴	PCV ⁸				
Frufti, Rubella, Parotit					MMR ²	MMR ⁷		
Difteri, Tetanoz						DT ⁸	DT ⁹	DT ⁹
Human papilloma virus							HPV ¹⁰	

- Vakcina BCG administrohet me daljen nga materniteti. Erit në fund të vitit të parë, fëmija vaksinohet sipas anarces paraprake të tuberkulozës.
- Vakcina HepB administronhet brenda 24 orëve të para pas lindjes, si një vakcinë e vetme.
- Fëmija vaksinohet (drita) dhe (b) me vakcinën që përmbanë, si çdo përmirësi DTaP, Hib, HepB dhe IPV.
- Fëmija vaksinohet (drita) dhe (b) me vakcinën (vaksinë, a i parë) me një vakcinë përbërëse të përmirës DTaP, Hib dhe IPV.
- Fëmija vaksinohet me vakcinën kundër hepatitit B (HepB). Vakcinën (b) jo më vonë se 12-15 javë pas lindjes, dhe në ditën 6 javë. Drita është 18 javë pas lindjes dhe në ditën 18 javë.
- Vaksinimi kryhet për tërë kohën të moshës 6 vjeç. Nëse i detyrohet vakt nga moshë e mëvonshme në mononit të fëmijës të vaksinimit:
 - Fëmijëve të moshës 2 deri në 11 muaj u jepet 3 drita me interval 2 muaj.
 - Fëmijëve të moshës 12 deri në 23 muaj u jepet 2 drita me interval jo më shumë se 3 muaj.
 - Fëmijëve të moshës 2 deri në 5 vjeç u jepet një dritë e vakcinës PCV.
- Drita e parë e vakcinës MMR u jepet fëmijëve në moshën 12-15 muaj dhe drita e dytë (vaksinimi para fillimit të kësaj se parë dhe nëse është e mundur në krah të gjatë të 11-12 vjeç) si vakcinë e vetme.
- Fëmijëve të moshës 5-6 vjeç u jepet fëmijëve para fillimit të kësaj se parë dhe nëse është e mundur në krah të gjatë të 11-12 vjeç, dhe vaksinimi i kësaj se parë në krah të gjatë të 11-12 vjeç, dhe vaksinimi i kësaj se parë në krah të gjatë të 11-12 vjeç.
- Fëmijët vaksinohen me vakcinën IPV në klasën e gjatë të 11-12 vjeç si vakcinë e vetme.

Tabela 13 - Pasqyra e vaksinimit ne qendrat e KPSH Gjakove per vitin 2025

	Vaksina	Femije
QKV - QKMF	15,413	7,967
QMF1	408	408
QMF ORIZE	2,342	1,547
QMF ERENIKU	490	370
QMF PONOSHEC	1,172	616
QMF SKIVJAN	1,175	639
QMF CERMJAN	770	390
QMF ROGOVE	1,081	673
QMF DARDANIA	894	534
KOMUNITETI R.A.E.	1,239	547
Total	24,984	13,699

Gjate vitit 2025 kemi realizuar vaksinimin e grupë moshave sipas planifikimit në përqindje:

fëmijë 0 - 11 muaj, ku kemi vaksinuar	93.0 %
fëmijë 12 - 24 muaj, ku kemi vaksinuar	89.0 %
nxënës 6 - 7 vjeç, ku kemi vaksinuar	89.0 %
nxënës 12 - 13 vjeç, ku kemi vaksinuar	87.0 %
nxënës 12 - 13 vjeç, me vaksinën HPV	77.0 %
Maturantë 18 vjeç	98.0 %

Tabela 14 - Pasqyra e realizimit te vaksinimit per vitin 2025 dhe krahasimi me vitin 2024

Mosha e fëmijëve dhe nxënësve	Përqindja 2024	Përqindja 2025
Fëmijë 0 - 11 muaj	98.60 %	93.00 %
Fëmijë 12 - 24 muaj	98.00 %	89.00 %
Nxënës 6 - 7 vjeç	99.73 %	89.00 %
Nxënës 12 - 13 vjeç	88.48 %	87.00 %
Nxënës 12 - 13 vjeç me HPV		77.00 %
Maturante 18 vjeç	80.31 %	98.00 %

Nderkohe nga 1 tetori QKMF – Njesia e vaksinimit dhe imunizimit eshte furnizuar nga IKSHPK me 4,000 doza te vaksines kater valente te gripit sezonal, te cilat jane shpernda ne 9 qendrat e vaksinimit (QKMF dhe 8 QMF dhe eshte filluar me vaksinimin. Gjate vitit 2025 jane vaksinuar 3,522 persona nderkohe qe vaksinimi vazhdon edhe me tutje.

Vaksinimi me vaksine e gripit sezonal, total 3522:

- Mbi moshen 65 vjeç 2450
- Nen moshen 65 vjeç 979

- Punëtor shëndetësor 89
- Femije 4

Vaksina e gripit sezonal e administruar sipas viteve:

- Gjatë vitit 2021 – 3,593 doza të vaksinës,
- Gjatë vitit 2022 - 3,704 doza të vaksinës,
- Gjatë vitit 2023 – 3,602 doza të vaksinës
- Gjatë vitit 2024 – 3,247 doza të vaksinës.
- Gjatë vitit 2025 – 3,522 doza të vaksinës

Tab.15. Vaksina e gripit sezonal

Vaksina e Gripit	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025
Doza	3704	3602	3247	3522

7.6. BARNATORJA QENDRORE E QKMF

Barnatorja Qëndrore e QKMF, është njësi organizative e QKMF e cila përkujdeset për vlerësimin e nevojave, planifikimin dhe sigurimin, si dhe ruajtjen dhe shpërndarjen e medikamenteve dhe materialeve të ndryshme shëndetësore për nevojat e KPSH të komunës (QKMF) nga Lista Esenciale e Barnave, e lejuar nga Ministria, dhe të përshkruara në recetat unike nga Mjekët e Sektorit të Mjekësisë Familjare.

Në Barnatoren Qendrore të QKMF- së, gjatë vitit 2025 janë shpërndarë medikamente dhe materialeve të ndryshme shëndetësore për nevojat e KPSH të komunës (QKMF) nga Lista Esenciale e Barnave, e lejuar nga Ministria, si dhe shpërndarja e rregullt mujore e Insulinave.

Tab.16. Shpërndarja e Insulinave për pacientet sipas muajve në vitin 2025

QKMF - RAPORTI INSULINAVE 2025							
	Muaji 2025	Pacientat në listën e barnatores	Pacientat që kanë marr insulinë	Analog insuline me veprim të shpejtë (Novorapid)	Analog insuline me veprim të zgjatur (Levemir)	Analog insuline bifazike me veprim të mesëm dhe të shpejtë (Novomix)	Totali
1	Janar	1136	921	1193	995	3091	5279
2	Shkurt	1149	843	1055	558	2515	4128
3	Mars	1152	874	1145	1210	2950	5305
4	Prill	1167	956	1135	922	2900	4957
5	Maj	1137	904	1167	908	3340	5415
6	Qershor	1146	824	1054	951	2647	4652
7	Korrik	1156	901	1219	1014	3286	5519
8	Gusht	1175	948	1615	1114	3038	5767
9	Shtator	1185	834	702	894	2447	4043
10	Tetor	1132	934	1243	1062	3576	5881
11	Nentor	1141	806	1083	926	2626	4635

12	Dhjetor	1150	953	1310	1079	3081	5470
	TOTAL	13826	10698	13921	11633	35497	61051

7.7. LABORATORI

Laboratori i Mjekësisë - Biokimi, pranë QKMF të Gjakovës është strukturë shëndetësore e cila ofron shërbime laboratorike (biokimike dhe hematologjike) për të gjithë popullatën dhe pacientët të cilët kërkojnë shërbime në nivelin e Mjekësisë Familjare, gjegjësisht në QKMF.

Kapaciteti dhe furnizimi i mirë me pajisje moderne laboratorike, lejon përpunimin e një numri të madhë të mostrave, si dhe një numër të madh të analizave hematologjike, analizave biokimike, testeve të hemostases dhe të analizës së urinës, HbA1C. Aparaturat që gjenden momentalisht në Laboratorët Biokimik-Hematologjik është e nevojshme të servisohen dhe kalibrohen sipas standardeve të caktuara, atëherë planifikohet të rritet numri llojit të shërbimeve (analizave) gjegjësisht edhe numri i shfrytëzuesve të shërbimeve.

Aktualisht janë të paisura dhe të kompletuara 5 Laboratore, gjegjësisht në QMF 1-laboratori qendrorë, dhe 4 në regjione të ndryshme, në QMF Rogovë, në QMF Cermjan, në QMF Ponoshec dhe në QMF Skivjan.

Gjatë periudhës së raportimit për vitin 2025 janë kryer në total rreth: 120,300 testime laboratorike për 8,020 pacientë, të ndare në grupmosha: 502 (0-3 vjeq), 793 (3-10 vjeq), 1549 (10-18 vjeq), 2471 (19-65 vjeq) dhe 2705 (mbi 65 vjeq).

Tab.17. Nr i pacienteve sipas moshes

Pasqyra e pacienteve sipas moshes					
Mosha	0 – 3 vjeq	3 – 10 vjeq	10 -18 vjeq	19 – 65 vjeq	Mbi 65 vjeq
Nr. i pacienteve	502	793	1549	2471	2705
Gjithësej	8020				

Shërbimi i pacienteve për në hemodializë:

Janë realizuar shërbimet e transportit për në qendrën e dializës në Spitalin Regjional në Gjakovë, për 21 pacientë (numër i cili varion varesisht nga gjendja shëndetësore e pacienteve) 6 ditë në javë - nga e hënë deri të shtunën, në dy ndërrime (tri ditë në javë) me 12 dhe 9 pacientë.

Gjithashtu gjatë vitit 2025, u është siguruar oksigjenatorë për shfrytëzim të përkohshëm 10 pacientëve.

